

Raportet vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes.

Përmbledhja

1	Hyrje	3
2	Performanca e Sektorit UK	4
2.1	Analiza e Treguesve Kryesore të Performancës	4
2.1.1	Treguesit e Performancës së Sektorit UK për vitet 2022, 2023	5
2.1.2	Performancë Financiare e Sektorit 2022-2023	6
2.1.3	Zërat e kostove në raport me KDO	6
3	Performanca e Shoqërive Rajonale	7
3.1	Analizimi i Treguesve të Performancës	7
3.1.1	Ujë Pa të Ardhura	8
3.1.2	Matja e vëllimit të prodhimit	9
3.1.3	Norma e Arkëtimit	10
3.1.4	Norma e Arkëtimit Korent	10
3.1.5	Norma e Arkëtimit Korent Familjar	11
3.1.6	Arkëtimit Korent Ente Private	12
3.1.7	Arkëtimit Korent Institucione	13
3.1.8	Arkëtimit Total	15
3.1.9	Mbulim KDO/Arkëtimit Total	16
3.1.10	Lidhjet e reja	19
3.1.11	Eficienca staf ujësjellësi/1000 lidhje ujësjellësi	19
3.1.12	Matja e konsumit	20
4	Konkluzione & Rekomandime	21

1 Hyrje

Zona e mbulimit me shërbim e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër, në zbatim të VKM 302 Dt.11.05.2022,për “Politikat kombëtare për riorganizmin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe për përpunimit të ujërave të ndotura ”, është zgjeruar brenda kufinjve të zonës së juridiksionit të Qarkut Shkodër. Qarku i Shkodrës ka në juridiksionin e saj rrethin e Malësisë së Madhe, të Pukës dhe të Shkodrës. Rrethi i Shkodrës ka të integruar Bashkinë Shkodër dhe Bashkinë Vau Dejës, Rrethi i Pukës ka të integruar Bashkinë Fushë – Arrëz dhe Bashkinë Pukë.Rrethi Malësi e Madhe ka të integruar Bashkinë Koplik. Gjatë vitit 2023 u arrit të përfundohet marrja në dorëzim e të gjitha sistemeve të ujësjellësit dhe KUZ, të katër njesive të tjera administrative: Fushë Arrëz, Pukë, Vau Dejës dhe Malësi e Madhe. Pavarësisht se zona e shërbimit është rritur ndjeshëm, problem i madh është mbulimi me shërbim, sidomos për zonat rurale, ku niveli aktual i mbulimit është 32%, ndërsa niveli i përgjithshëm i mbulimit me shërbimin e ujësjellësi vlerësohet të jetë rreth 54%, mbulimi me shërbimin e kanalizimeve është akoma më i ulët dhe vlerësohet se 33% e popullsisë së zonës së re të shërbimit i mundësohet shërbimi i largimit të ujërave të ndotura.



	Popullsia totale e shërbimit	Njësia Shkodër	Njësia Malësia e Madhe	Njësia Vau i Dejës	Njësia Fushë Arrëz	Njësia Pukë
Zona e shërbimit të popullsisë						
Totali	334,914	208,618	54,156	51,724	4,800	15,616
Urbane	135,580	115,215	3,908	7,573	3,800	5,116
Rurale	199,334	93,403	50,248	44,151	1,000	10,500
Popullsia e shërbyer me furnizimin me ujë						
Totali	180,533	126,204	31,147	12,488	4,118	6,576
Urbane	116,808	102,626	3,912	3,188	3,118	3,964
Rurale	63,725	23,578	27,235	9,300	1,000	2,612
Mbulimi me shërbimin e furnizimin me ujë						
Totali	54%	60%	58%	24%	86%	42%
Urbane	86%	89%	100%	42%	82%	77%
Rurale	32%	25%	54%	21%	100%	25%

Nga këndvështrimi strukturor demografik në Bashkinë Shkodër banojnë rreth 62 % e popullsisë së qarkut Shkodër, 16% në Bashkinë e Malësisë së Madhe, 15.6% në Bashkinë e Vau Dejës, 5% në Bashkinë Pukë dhe 1.4% në Bashkinë Fushë Arrëz. Popullsia aktuale e raportuar e qarkut Shkodër është 334,914 banorë. Dendësia mesatare e popullsisë së qarkut është 99 banorë/km², por kjo dendësi varion nga 239 për Bashkinë Shkodër, në 56 për Bashkinë Malësi e Madhe, 103 për Bashkinë Vau Dejës, 31 për Bashkinë Pukë dhe 9 për Bashkinë Fushë Arrëz. Pjesa më e madhe e fshatrave nuk kanë mbulim me shërbimin e furnizimit me ujë, duke bërë të dukshme nevojën që kanë këto zona për investime kapitale në ndërtimin e rrjeteve të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Në Shkodër mund të përmendim fshatrat: Trush, Bardhaj. Në njesinë administrative Malësi e Madhe pa furnizim me ujë është njesia e Kelmendit, me përjashtim të Tamarës (Vermosh, Lëpushë, Selcë, Brojë, Kozhnja, Nikç, dhe Vukël). Në njesinë administrative Vau Dejës mund të përmendim fshatrat: Mjedë (në proces implementimi), Kosmaç, Stajkë, Vig, Nelë e Vogël, Nelë e Madhe, Gjobardhaj, Gomsiqe, Dush, Karmë, Vukaj, Palaj-Gushtë, Koman, Benë, Barcollë, Ukbibaj, Vukjakaj-Gegaj, Vile, Arrë, Telume-Kllogjen, Malagji-Kajvall, Toplane, Sermë etj. Gjithashtu vlen të përmendet fakti që me përjashtim të Mjedes pjesa tjetër e fshatrave janë pothuajse të shpopulluar. Në

njësinë administrative Pukë mund të përmendim fshatin Qerret ku popullsia e juridiksionit mendohet të jetë rreth 1500 banorë të cilët nuk marrin furnizim me ujë. Kurse njësia administrative Fushë Arrëz është e vetmja që ka pothuajse mbulim 100% me furnizim me ujë të popullsisë.

2 Performanca e Sektorit UK

2.1 Analiza e Treguesve Kryesore të Performancës

Të dhënat dhe informacionet për përgatitjen e raportit janë mbledhur dhe përpunuar nga sektori i planifikim raportimit dhe analizës i SHRUK Shkodër, bazuar në të dhënat që raportohen periodikisht tek AKUK nga Shoqëria. Vlerësimi i Performancës së Shoqërisë bëhet kundrejt treguesve dhe synimeve të përcaktuara në Kontratën e Performancës, të lidhur mes AKUK dhe Shoqërisë Rajonale UK Shkodër për vitin 2025 si edhe në Metodologjinë e Vlerësimit të hartuar nga AKUK.

Qëllimi i këtij raporti është të vlerësojë në mënyrë të plotë performancën tekniko-financiare të shoqërisë së ujësjellës-kanalizimeve, duke analizuar efikasitetin operativ, cilësinë e shërbimit, gjendjen e infrastrukturës, strukturën dhe aftësinë financiare, si dhe përputhshmërinë me rregulloret dhe standardet e vendosuar nga institucionet mbikqyrëse. Raporti synon të identifikojë dobësitë dhe rreziqet kryesore, të vlerësojë nevojat investuese dhe kostot e riparimeve/modernizimeve, dhe të ofrojë rekomandime praktike për përmirësim të performancës operationale, qëndrueshmërisë financiare dhe menaxhimit të burimeve, me qëllim sigurimin e shërbimeve të besueshme dhe të qëndrueshme për komunitetin.

Fillimisht këta tregues i kemi krahasuar me treguesit e një viti më parë për të treguar ecurinë e treguesve të SHRUK Shkodër. Më pas këta tregues janë krahasuar me objektivin e vitit 2025, për të evidentuar përmbushjen e standartave të përcaktuara në kontratën e performancës.

2.1.1 Treguesit e Performancës së SHRUK Shkodër për vitet 2024, 2025

Tregues Performance	Njësia Matëse	Viti 2024	Viti 2025	Ndryshimi
Mbulimi i Koshtos Operacionale /arkëtim korent	%	45%	67%	+ 22%
Mbulimi i Koshtos Operacionale /arkëtim total	%	90%	102%	+ 12%
Mbulimi i Koshtos Operacionale / faturim	%	74%	93%	+ 19%

Ujë pa të Ardhura	%	64%	62%	- 2%
Norma e arkëtimit Korent	%	61%	64%	+ 3%

Gjatë vitit 2025 treguesit e performances së Shoqërisë Rajoinale Ujësjellës Kanalizimeve Shkodër kanë pësuar përmirësim të ndjeshëm krahasuar me një vit më parë.

- Treguesi normës së arkëtimit korent krahasuar me vitin 2024 në vitin 2025 është rritur me 3%.
- Treguesi mbulimit të KDO/ Arkëtim Total, ka arritur në nivel shumë të mirë në vitin 2025 dhe tregon një menaxhim të mirë lidhur me kostot dhe të ardhurat të shoqërisë. Krahasuar me vitin 2024 në vitin 2025 mbulimi i KDO/Arkëtim Total rritet në masën 12%

2.1.2 Performancë Financiare e SHRUK Shkodër, 2024-2025

E vlerësuar në tregues financiar të ardhurat dhe kostot janë përmirësuar në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022:

- Kosto e Operacionale (KDO) ulur me 1%;
- Faturimi rritur me 44%;
- Arkëtimi Korent rritur 47%.

2.1.3 Zërat e kostove në raport me KDO



Pesha që zënë zërat kryesore të kostos janë 58% personeli (paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore), 31% energjia elektrike dhe 11% të tjerat ku përfshihen (kimikate, mirëmbajtja, shërbime të nënkontraktuara dhe të tjera). Duke qënë se furnizimi i njesisë administrative Shkodër dhe Vau Dejës me ujë të pijshëm realizohet përmes ngritjes mekanike nga stacionet e pompimit të ujit të pijshëm, kostot e energjisë ka ndikuar jashtzakonisht shumë në treguesit financiar të shoqërisë, duke e vendosur SHRUKSH-në në një pozitë mjaft të vështirë financiare. Megjithatë shoqëria ka punuar shumë në mbajtjen e këtyre shpenzimeve në nivel konstant nëpërmjet optimizimit të orareve të pompave të ndezuara me qëllim garantimin edhe të furnizimit të popullsisë me ujë, por edhe të kursimit të energjisë. Po ashtu është punuar shumë edhe në eliminimin e defekteve me qëllim uljen e nivelit të humbjeve të teknike.

Niveli i shpenzimeve të vitit 2025 nuk e ka tejkaluar nivelin e shpenzimeve të parashikuar për këtë vit, madje shenojnë rreth 20% më pak. C'ka tregon se shoqëria pavarësisht vështirësive të shumta operative ka arritur të mbajë nën kontroll shpenzimet e saj.

3 Performanca e Shoqërive Rajonale

3.1 Analizimi i Treguesve të Performancës.

Në mbyllje të vitit 2025 rezultatet kryesore për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Tregues Performance	Viti 2024	Viti 2025	Ndryshimi
Ujë pa të Ardhura	64 %	62 %	-2%
Norma e Arkëtimit Korente	61%	62%	+1%
Mbulim KDO/Arkëtim Total	90%	102%	+ 12%

Uji pa të ardhura për SHRUK Shkodër i krahasuar me vitin 2024 paraqitet lehtësisht i përmirësuar. Në vitin 2025 faturimi ka pësuar një rënie me 3% krahasuar me vitin paraardhës, duke reflektuar efektin e rritjes së tarifave në konsumin e sasisë së ujit të pijshëm. Gjithsesi rritja e tarifave ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e situatës financiare të shoqërisë.

- Norma e arkëtimit korente ka një rritje me 1% krahasuar me vitin 2024
- Treguesi mbulimit KDO/Arkëtim Total në vitin 2025 paraqitet në nivelin 102% nga 90% që ishte në vitin 2024, pra kemi një rritje me 12%.

Në vitin 2025 krahasuar me 2024 arkëtimi total nga aktiviteti kryesor është rritur me 29%, arkëtimi total + të ardhura nga shërbime të tjera është rritur me 29.2% ndërsa kostot operacionale janë zvogëluar me 1%.

Për të adresuar përgjegjësitë lidhur me mbarëvajtjen e shoqërive, AKUK përcaktoi tregues dhe objektiva të qarta performance për vitin 2025 që u nënshkruan midis Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme dhe Administratorëve të Shoqërive Rajonale nëpërmjet dokumentit “Kontratë Performance”

Performanca e vitit 2025 pasqyrohet përmes treguesve:

- ☐ Ujë pa të ardhura
- ☐ Matja e vëllimit të prodhimit
- ☐ Arkëtim Korent
- ☐ Arkëtim Total
- ☐ Mbulim KDO/Arkëtim Total
- ☐ Lidhjet të reja
- ☐ Eficienca e Stafit
- ☐ Matja e konsumit
- ☐ Likujdim i Faturës së Energjisë
- ☐ Likujdim Debi Energjie

3.1.1 Ujë Pa të Ardhura

Ujë Pa të Ardhura është sasia e ujit të pafaturuar kundrejt totalit të ujit të prodhuar, i cili mund të klasifikohet në humbje komerciale dhe humbje teknike.

- ☐ Humbjet komerciale vijnë nga menaxhimi jo i mirë si dhe nga lidhjet e paligjshme.
- ☐ Humbjet teknike vijnë si pasojë e amortizimit të sistemeve.

Niveli i ujit pa të ardhura në vitin 2025 për SHRUK Shkodër rezulton 62% dhe i krahasuar me vitin 2024 ka një përmirësim të lehtë prej 2%.


Uji pa të ardhura ose humbjet (teknike dhe administrative) vazhdojnë të mbeten një sfidë madhore e të gjitha veprimtarive të SHRUK Shkodër. Edhe gjatë këtij viti niveli i humbjeve llogaritet të jetë 62 %.

Nivel humbjesh ky që i afrohet goxha targetit të vendosur nga AKUK dhe pritshmërive tona për vitin 2025. Niveli i humbjeve po ta krahasojmë me atë të një viti më pare ka rënë më 2%.

Peshën më të madhe të këtyre humbjeve e zë njesia administrative e Shkodrës dhe ajo e Vaut të Dejës. Kjo për arsye të rrjetit tejet të amortizuar, i cili si rrjedhojë sjell humbje të mëdha teknike duke e përkeqësuar ndjeshëm këtë tregues. Ndërsa tre njesitë administrative të tjera kanë një nivel uji pa të ardhura nën 50%.

Si rezultat i punës me në fokus evidentimin e lidhjeve të paligjshme, intalimin e matësive të rinj, zëvendësimit të matësve me problem, evidentimin dhe shqyrtimin e rasteve me konsum 0, është arritur mbajtja nën kontroll e këtij treguesi. Po ashtu gjatë këtij viti janë realizuar rreth 1100 riparime të tubacioneve të dëmtuara për eliminimin e humbjeve të ujit si rrjedhojë e këtyre defekteve. Pritshmëritë tona për mujtë pasardhës, po të vazhdohet të punohet me këto ritme janë që niveli i ujit pa të ardhura të jo vetëm të arrijë targetin prej 62% të vendosur nga AKUK por ta përmiresojë këtë target. Siç mund të shohim grafikun e mëposhtëm uji pa të ardhura gjatë pesëmuajorit të parë të qënë në nivete mbi 62%, tregues ky që është përmirësuar ndjeshëm në muajt në vazhdim

Grafiku Nr. 2: Niveli i ujit pa të ardhura sipas njesive krahasuar me objektivin.



Sikurse shihet nga grafiku njesitë klasifikohen në tre nivele:

Nivel i lartë i humbjeve: Shkodër, Vau Dejës.

Nivel mesatar i humbjeve: Pukë.

Nivel i pranueshëm i humbjeve: Malësi e Madhe, Fushë Arrëz.

3.1.2 Matja e vëllimit të prodhimit

Volumi i ujit të prodhuar në total për shoqëritë rajonale në vitin 2025 është rreth 13 mln m³, nga të cilat 300 mijë m³ ose rreth 2.5% është i matur. Ndërkohë ky indikator ka si target të vendosur nga AKUK nivelin 72%. Konkretisht niveli i ujit të prodhuar të matur në njesinë administrative Vau Dejës kap shifren 37%. Për njesitë e tjera administrative si Shkodër, Pukë, Fushë Arrëz dhe Malësi e Madhe sistemi i matjes së ujit të prodhuar është kryesisht me vlerësim.

Vendosja e matësave në prodhim për një kompani ujësjellësi është thelbësore për menaxhimin efikas të burimeve ujore dhe funksionimin e qëndrueshëm të shërbimit. Matësit mundësojnë matjen e saktë të ujit të prodhuar dhe të shpërndarë, ndihmojnë në identifikimin e humbjeve teknike dhe vjedhjeve, si dhe rrisin transparencën në faturim. Përmes tyre, kompania përmirëson planifikimin operacional, ul kostot, rrit të ardhurat dhe siguron përdorim racional të ujit, duke kontribuar njëkohësisht në mbrojtjen e burimeve natyrore dhe rritjen e besimit të konsumatorëve.

Për përmirësimin e treguesit të matjes në prioritetin e investimeve, veç të tjerash, shoqëria ka instalimin e matësave të prodhimit. Pajisja e të gjitha burimeve me matës prodhimi përcakton edhe saktësinë e nivelit të ujit pa të ardhura për të gjitha sistemet e furnizimit.

Aktualisht për SHRUK Shkodër është akorduar fondi për studim projektimin: Furnizim dhe vendosje e matesave elektromagnetik për ujin e pijshëm ne dalje te rezervuarve,ruajtja,leximi ne distancë, perpunimi i te dhenave ne postin qëndror të U.K Rajonale Shkodër. Ky projekt është iniciuar në vitin 2025 dhe pritët të finalizohet në vitin 2026.

3.1.3 Norma e Arkëtimit


Norma e Arkëtimit është shprehja në përqindje e shumës së arkëtuar ndaj shumës së faturuar për shërbimin ujësjellës-kanalizime e cila kategorizohet në Normë Korente dhe Normë Totale.

3.1.4 Norma e Arkëtimit Korent

Norma e Arkëtimit është një nga treguesit financiar më të rëndësishëm të performancës së shoqërive, që lidhet me qëndrueshmërinë financiare dhe likuiditetin e shoqërisë.

Norma e Arkëtimit Korent përfshin arkëtimin brenda muajit të faturës së muajit paraardhës për tre kategoritë: Familjar, Ente Private dhe Institucione.

3.1.5 Norma e Arkëtimit Korent Familjar



Objektivi i normës së arkëtimit korent Familjar për vitin 2025 për të gjitha shoqëritë rajonale ishte në nivelin 72%. Aktualisht norma korente e arkëtimit për kategorinë e klientin familjar e SHRUK Shkodër kap vlerën 59%. Vlerësuar sipas rezultateve të arritura vjetore njesitë administrative i grupojmë në tre nivele:

Niveli i mirë 91%-71%: Vau Dejës

Nivel i mesëm 70%- 63%: Pukë dhe Fushë Arrëz

Nivel i ulët 58% - 28%: Shkodër dhe Malësi e Madhe.


Njesia administrative që ka realizuar objektivin e performancës është vetëm Vau Dejës, ndërsa njesitë e tjera administrative nuk e kanë arritur këtë objektiv. Rritja e tarifave në vitin

2025 ka sjellë rritje të barrës financiare për një pjesë të konsumatorëve, veçanërisht familjarë dhe biznese të vogla, duke ndikuar negativisht në aftësinë paguese dhe duke reflektuar ulje të arkëtimit korent.

Një pjesë e konsumatorëve kanë kaluar në pagesa të pjesshme ose me vonesë, duke ulur normën e arkëtimit brenda vitit fiskal. Kjo situatë përfaqëson një efekt tranzitor të rritjes tarifore, i cili pritët të stabilizohet në periudhat pasuese përmes:

- ✓ masave për lehtësimin e pagesave (këste, marrëveshje shlyerjeje),
- ✓ forcimit të mekanizmave të arkëtimit,
- ✓ dhe rritjes graduale të disiplinës financiare të konsumatorëve.

3.1.6 Arkëtimi Korent Ente Private



Objektivi i normës së arkëtimit korent Ente Private për vitin 2025 për të gjitha shoqëritë rajonale ishte në nivelin mbi 75%. Aktualisht norma korente e arkëtimit për kategorinë e klientin familjar e SHRUK Shkodër kap vlerën 61%.

Vlerësuar sipas rezultateve të arritura vjetore njësitë administrative i grupojmë në tre nivele:

Nivel i mirë 86% -72%:	Fushë Arrëz
Nivel i mesëm 67% - 60%:	Shkodër, Vau Dejës, Pukë
Nivel i ulët 57% - 33%:	Malësi e Madhe.


Njesia administrative që ka realizuar objektivin e performancës për vitin 2025 është vetëm **Fushë, Arrëzi**. Mosrealizimi i objektivit të normës së arkëtimit korent prej 75% për kategorinë biznes gjatë vitit 2025 lidhet kryesisht me ndikimin e drejtpërdrejtë të rritjes tarifore, të kombinuar me faktorë ekonomikë dhe operacionalë që kanë ndikuar në aftësinë paguese të subjekteve.

Faktorët kryesorë:

1. Rritja e tarifave në vitin 2025 ka reflektuar rritje të menjëhershme të faturave mujore për subjektet biznes, veçanërisht për ato me konsum të lartë, duke sjellë vonesa në pagesat korente.
2. Një pjesë e bizneseve kanë kaluar në pagesa selektive ose të pjesshme, duke prioritarizuar detyrime të tjera operative (tatime, paga, energji).
3. Biznese sezonale ose me aktivitet të paqëndrueshëm, sidomos jashtë sezonit turistik, kanë shfaqur ulje të likuiditetit dhe pamundësi për shlyerje në afat.
4. Rritja tarifore ka sjellë ankesa dhe kërkesa për verifikim faturash, çka ka vonuar pagesat deri në sqarimin administrativ.
5. Një pjesë e subjekteve kanë akumuluar detyrime të reja pa shlyer detyrimet korente brenda vitit fiskal, duke ulur normën e arkëtimit.

Këta faktorë kanë ndikuar që norma e arkëtimit korent për kategorinë biznes të rezultojë nën objektivin 75%, duke përfaqësuar një situatë tranzitore pas ndryshimit tarifar, e cila kërkon masa specifike korrigjuese për vitin pasardhës.

3.1.7 Arkëtimi Korent Institucione.



Objektivi i normës së arkëtimit korent për kategorinë Institucione për vitin 2025 për të gjitha shoqëritë rajonale ishte në nivelin mbi 90%. Aktualisht norma korente e arkëtimit për kategorinë e klientin familjar e SHRUK Shkodër kap vlerën 90%, duke e përmbushur këtë objektivi.

Vlerësuar sipas rezultateve të arritura vjetore njesitë administrative i grupojmë në tre nivele:

Nivel shumë i mirë 100% -90%: Malësi e Madhe, Shkodër

Nivel i mesëm 86% -72%: Pukë, Vau Dejës, Fushë Arrëz.

Njesitë administrative që kanë realizuar objektivin e performancës për vitin 2025 janë Malësia e Madhe dhe Shkodra. Ndërsa tre njesitë e tjera administrative i janë afruar goxha por nuk e kanë arritur.

Mosrealizimi i normës së arkëtimit korent për kategorinë institucione gjatë vitit 2025 lidhet kryesisht me mekanizmat e veçantë të financimit dhe procedurat burokratike të pagesave publike, të cilat nuk ndjekin ciklin mujor të faturimit.

Faktorët kryesorë:

1. Pagesat nga institucionet publike realizohen sipas alokimeve buxhetore dhe procedurave administrative, shpesh me vonesa krahasuar me afatet e faturimit.
2. Mungesa ose vonesa në fondet buxhetore për disa institucione ka sjellë pamundësi për shlyerje në kohë të faturave korente.
3. Pagesat shpesh kryhen në periudha të grumbulluara (jo mujore), duke reflektuar normë më të ulët arkëtimi brenda vitit raportues.
4. Rritja e tarifave në vitin 2025 ka kërkuar rishikim të fondeve të planifikuara, duke krijuar boshllëk të përkohshëm midis detyrimeve dhe fondeve të disponueshme.
5. Në disa raste, faturat janë subjekt i verifikimeve administrative të brendshme, duke shtyrë procesin e pagesës.

Masat për përmirësimin e arkëtimit nga institucionet


- ✓ Përmirësimi i normës së arkëtimit korent për kategorinë institucione kërkon masa strukturore dhe koordinim ndërinstitutional, të cilat parashikohen të zbatohen në periudhat pasuese:
- ✓ Nënshkrimi i marrëveshjeve të posaçme me institucionet kryesore për afate të qarta pagese.
- ✓ Harmonizimi i ciklit të faturimit me ciklin buxhetor, për të shmangur vonesat sistematike.
- ✓ Ndjekje e centralizuar e debitorëve institucionalë, me raportim periodik.
- ✓ Vendosja e planeve të shlyerjes për institucionet me detyrime të akumuluar.
- ✓ Forcimi i komunikimit zyrtar me autoritetet financiare përkatëse për sigurimin në kohë të fondeve.
- ✓ Monitorim mujor i arkëtimit për këtë kategori dhe ndërhyrje të hershme në rast devijimesh.

3.1.8 Arkëtim Total

Norma e Arkëtimit Total përfshin arkëtimin korent + debi të prapambetura.

Objektivi i normës së Arkëtimit Total për vitin 2025 për të gjitha shoqëritë rajonale ishte në nivelin mbi 105%.

Në grafikun më poshtë paraqiten njesitë administrative me normat përkatëse të arkëtimit:



Në mbyllje të vitit 2025 rezulton se nga debitë e prapambetura janë arkëtuar rreth 141.2 mln lekë.

Vlerësuar sipas rezultateve të arritura vjetore njësitë administrative i grupojmë në dy nivele:

Nivel i mirë: Vau Dejës.

Nivel mesatar: Fushë Arrëz, Pukë, Shkodër dhe Malësi e Madhe.

Për arkëtimin e prapambetur, vështirësia në mbledhjen e tyre vjen si rezultat i disa faktorëve:

- ✓ Vështirësi objektive në rikuperimin e debive të vjetra, të akumuluar prej vitesh dhe me probabilitet të ulët arkëtimi.
- ✓ Rishikimin dhe pastrimin e portofolit të debitorëve, ku një pjesë e detyrimeve janë klasifikuar si të vështira ose të pambledhshme.
- ✓ Fokus më të madh të burimeve administrative në arkëtimin korent, në dëm të ndjekjes intensive të detyrimeve historike.

Prania e pallateve me sistem furnizimi në kolonë, si dhe e objekteve të vjetra dhe të braktisura, ka ndikuar ndjeshëm si në arkëtimin korent, ashtu edhe në arkëtimin e prapambetur gjatë vitit 2025. Në pallatet e furnizuara me sistem kolonë, faturimi realizohet afrofe, për shkak të mungesës së matjes individuale të konsumit. Në këto kushte, ndërprerja e furnizimit me ujë për kontratat debitore nuk mund të aplikohet në mënyrë selektive, pasi shkyçja e linjës kryesore do të sillte ndërprerjen e furnizimit për të gjithë pallatin, përfshirë edhe konsumatorët korrektë.

Si pasojë:

- Nuk është e mundur penalizimi individual i debitorëve, pa cenuar të drejtat e konsumatorëve që kryejnë pagesat rregullisht.
- Aplikimi i masave shtrënguese bëhet i paefektshëm ose i pazbatueshëm, duke ulur presionin për shlyerjen e detyrimeve.
- Arkëtimi korent dhe ai i prapambetur ndikohet negativisht, për shkak të mungesës së instrumenteve operative të ndëshkimit selektiv.

Kjo situatë përfaqëson një problem strukturor të rrjetit, i cili kërkon zgjidhje afatgjata përmes kalimit në matje individuale dhe ristrukturimit të sistemit të furnizimit, duke garantuar trajtim të drejtë dhe eficient të konsumatorëve.

Po ashtu në objektet e vjetra ose të braktisura, pamundësia për identifikimin e përdoruesit aktiv e bën të vështirë rikuperimin e detyrimeve historike.

Detyrimet e akumuluar në këto objekte kanë probabilitet të ulët arkëtimi, duke ndikuar negativisht në normën e arkëtimit të prapambetur.


Mungesa e dokumentacionit të pronësisë ose ndryshimet e shpeshta të përdoruesve e vështirësojnë ndjekjen administrative dhe ligjore.

Si pasojë, këto struktura përfaqësojnë zona problematike strukturore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në performancën e përgjithshme të arkëtimit dhe kërkojnë zgjidhje afatmesme dhe afatgjata.

3.1.9 Mbulim KDO/Arkëtim Total

Mbulimi i Kostove Operacionale është tregues i rëndësishëm i performancës financiare. Në Kostot Operacionale përfshihen kostot që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen duke përjashtuar kostot e amortizimi dhe huave financiare. Treguesi për vitin 2025 matet me raportin: Të ardhura totale (korente + debi + të tjera dytësore) /Kosto Operacionale.

Mbulimi i KDO-ve me arkëtimet totale sipas njesive të administrimit paraqitet si mëposhtë:




Njesitë administrative që mbulojnë mbi 100% Kostot Operacionale janë: **Malësia e Madhe, Puka dhe Fushë Arrëzi.**

Njesitë administrative që kanë nivel të pranueshëm në nivelin 74 - 99% janë Shkodra dhe Vau Dejës. Duke qënë se furnizimi i njesisë administrative Shkodër dhe Vau Dejës me ujë të pijshëm realizohet përmes ngritjes mekanike nga stacionet e pompimit të ujit të pijshëm, kostot e energjisë ka ndikuar jashtzakonisht shumë në treguesit financiar të shoqërisë, duke e vendosur SHRUKSH-në në një pozitë mjaft të vështirë financiare. Megjithatë shoqëria ka punuar shumë në mbajtjen e këtyre shpenzimeve në nivel konstant nëpërmjet optimizimit të orareve të pompave të ndezuara me qëllim garantimin edhe të furnizimit të popullsisë me ujë, por edhe të kursimit të energjisë. Po ashtu është punuar shumë edhe në eliminimin e defekteve me qëllim uljen e nivelit të humbjeve të teknik

Krahasuar me vitin 2024 mbulimi i Kostos Operacionale ka përmirësim në vitin 2025 për të gjitha njesitë administrative. Rol kyç në përmirësimin e këtij indikator luajnë rritja e nivelit të çmimeve dhe tarifave që kanë hyrë në fuqi në Janar të viti 2025.

Në mbyllje të vitit 2025, shoqëria rajonale arriti të mbulojë 102 % KDO/Arkëtim Total dhe e krahasuar me vitin 2024 rezulton se është rritur në masën 12%. Po ashtu për vitin 2025 shoqëria përfitoi subvencion për energjinë elektrike prej 60.14 mln.

Zërat e Kostove në raport me KDO



Si shihet edhe nga grafiku kostot më të larta janë Kosto për Energji dhe Kosto e Punës. Në vitin 2025 kosto e energjisë pati një reduktim të ndjeshëm për arsye të uljes së çmimit dhe të menaxhimit të konsumit në kwh.

3.1.10 Lidhjet e reja

Shtimi i lidhjeve të reja ndikon në rritjen e shërbimit të furnizimit me ujë si dhe në rritjen të ardhurave të shoqërisë. Për vitin 2025 lidhjet e reja janë rritur me 580

3.1.11 Efienca staf ujësjellësi/1000 lidhje ujësjellësi.



Efienca e stafit është një tregues mjaft i rëndësishëm pasi lidhet direkt me situatën financiare të shoqërisë. Kosto e punës është zëri që zë përqindjen më të madhe konkretisht 58% të kostove Operacionale. Treguesi për vitin 2025 u mat për punonjës ujësjellësi dhe kanalizime dhe lidhje ujësjellësi dhe kanalizime në total. Treguesi i eficiencës së stafit, i matur si raporti staf për 1,000 lidhje, për vitin raportues rezultoi 5.8, krahasuar me objektivin 5.9. Ky rezultat dëshmon një menaxhim efikas të burimeve njerëzore, ku ndërmarrja ka arritur të përmbushë kërkesat operative dhe të ofrojë shërbimin pa rritje të panevojshme të stafit. Ruajtja e këtij niveli nën objektivin e përcaktuar reflekton optimizim të strukturës organizative, përmirësim të organizimit të punës dhe përdorim më racional të burimeve njerëzore, pa ndikuar negativisht në cilësinë e shërbimit.

Objektivi për vitin 2025 u llogarit sipas kushteve specifike të secilës shoqëri rajonale kryesisht sipas shtrirjes territoriale dhe numrit të lidhje.

Në analizën e kryer sipas seciles njësi administrative për eficiencën e stafit rezultat si mëposhtë:

Tejkalimi i ndjeshëm i objektivit të treguesit staf për 1,000 lidhje në njësité administrative Malësia e Madhe, Vau Dejës, Pukë dhe Fushë Arrëz lidhet kryesisht me faktorë strukturorë dhe gjeografikë, dhe jo me mbingarkesë të pajustificuar të stafit. Kjo njësi karakterizohet nga densitet shumë i ulët i lidhjeve, shtrirje e gjerë territoriale, terren i theksuar malor dhe rrjet furnizimi të fragmentuar, çka kërkon ruajtjen e një niveli minimal stafi për garantimin e operimit dhe ndërhyrjeve emergjente. Si pasojë, numri relativisht i ulët i lidhjeve rrit artificialisht raportin staf/1,000 lidhje, pa reflektuar rritje reale të kostove operative apo ulje të eficiencës në terma absolutë.

Kjo situatë përfaqëson një devijim strukturor, i cili kërkon trajtim të diferencuar sipas njësive dhe rishikim të objektivave standarde për zonat rurale dhe malore.

3.1.12 Matja e konsumit

Matja e konsumit shprehet me raportin e lidhjeve me matës kundrejt numrin total të lidhjeve. Në mbyllje të vitit 2025 u instaluan rreth 890 matësa konsumi për lidhjet ekzistuese pa matës (me faturim afrofe) dhe niveli matjes arriti në:

- 76% për konsumatorët Familjarë;
- 91% për konsumatorët Ente Private;
- 96% Institucione.

E shprehur në numër janë instaluar:

- 753 matës për kategorine e klientit familjarë;
- 115 matës për ente private;
- 18 mates për institucione.

Niveli total i matjes për të tre kategoritë e klientit arrin 78% nga 76% që ishte në vitin 2024

4 Konkluzione & Rekomandime

KONKLUZIONE

- Shoqëria rajonale duhet të ketë në fokusin të saj reduktimin e ujit pa të ardhura duke eliminuar lidhjet e paligjshme dhe humbjet fizike në rrjet.
- Devijimet në faturim dhe arkëtim gjatë vitit 2025 janë kryesisht strukturorë dhe tranzitorë, të lidhur me rritjen e tarifave, kufizimet teknike të rrjetit dhe strukturën reale të konsumit.
- Sistemi kolonë dhe faturimi afrofe kufizojnë ndjeshëm masat ndëshkuese dhe ndikojnë negativisht në arkëtimin korent dhe të prapambetur.
- Arkëtimi nga bizneset dhe institucionet është ndikuar nga aftësia pague, sezonaliteti dhe procedurat burokratike të pagesave.
- Në nivel ndërmarrjeje, efienca e stafit rezulton brenda objektivit, ndërsa devijimet e larta në disa njësi janë pasojë e kushteve gjeografike dhe numrit të ulët të lidhjeve, jo e joeficiencës.



REKOMANDIME

- Rishikim i planifikimit dhe objektivave mbi bazë reale territoriale dhe

strukture.

- Kalimi gradual në matje individuale, veçanërisht në pallatet me sistem kolonë.
- Zbatim i planeve të posaçme të shlyerjes për bizneset dhe institucionet, pas rritjes tarifore.
- Objektiva të diferencuara të stafit për njësitë rurale/malore.
- Forcim i monitorimit mujor të KPI-ve dhe ndërhyrje të hershme korrigjuese.